

## Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 18

# Të ardhurat

*Ky version përfshin ndryshimet që kanë rezultuar nga IFRS të publikuar deri më 31 Dhjetor 2006*

Komiteti i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit publikoi SNK 18 *Të Ardhurat* në Dhjetor të vitit 1993. Ky Standard zëvendësoi SNK 18 *Njohja e Të Ardhurave* (publikuar në Dhjetor të 1982).

Ndryshime të vogla në SNK 18 u bënë si pasojë e daljes së SNK 39 (në 1998), SNK 10 (në 1999) dhe SNK 41 (në Janar të 2001).

Në prill 2001, Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit vendosi që të gjitha standardet dhe interpretimet e nxjerra sipas Akteve të mëparshme të vazhdojnë të jenë të zbatueshme derisa ato të ndryshohen apo të tërhiqen.

Që atëherë SNK 18 është ndryshuar me deklaratimet që vijojnë:

- SNK 39 *Instrumente financiare: Njohja dhe matja* (nxjerrë në Dhjetor 2003)
- SNRF 4 *Kontrata sigurimi* (nxjerrë në Mars 2004).

Interpretimet vijuese i referohen SNK 18:

- KIS-13 *Njësi të bashkëkontrolluara - Kontribute Jomonetare nga Sipërmarrësit* (nxjerrë në Dhjetor 1998, ndryshuar në Dhjetor 2003)
- KIS-27 *Vlerësimi i përmbajtjes së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të një qiraje* (nxjerrë në Dhjetor 2001)
- KIS-31 *Të ardhurat - Transaksionet barter (transaksione shkëmbimi) që përfshijnë shërbime reklame* (nxjerrë në Dhjetor 2001)
- KIRFN 12 *Marrëveshjet e Shërbimeve të Koncesionit* (nxjerrë në Nëntor 2006).

**PËRMBAJTJA**

*paragrafet*

**STANDARDI NDËRKOMBETAR I KONTABILITETIT 18  
TË ARDHURAT**

**OBJEKTIVI**

<b>OBJEKTI</b>	<b>1–6</b>
<b>PËRKUFIZIME</b>	<b>7–8</b>
<b>MATJA E TË ARDHURAVE</b>	<b>9–12</b>
<b>IDENTIFIKIMI I TRANSAKSIONEVE</b>	<b>13</b>
<b>SHITJA E MALLRAVE DHE PRODUKTEVE</b>	<b>14–19</b>
<b>SIGURIMI I SHËRBIMEVE</b>	<b>20–28</b>
<b>INTERESAT, TË DREJTAT NGA DHËNIA NE PËRDORIM DHE DIVIDENTËT</b>	<b>29–34</b>
<b>DHËNIA E INFORMACIONEVE SHPJEGUESE</b>	<b>35–36</b>
<b>DATA E HYRJES NË FUQI</b>	<b>37</b>

**Shtojcë**

Standardi Ndërkombetar i Kontabilitetit 18 *Të ardhurat* (SNK 18) paraqitet ne paragrafët 1–37. Të gjithë paragrafët kanë të njëjtën rëndësi, por ruajnë formatin e Standardit të KSNK pas miratimit nga BSNK. SNK 18 duhet të lexohet në kontekst me *Objektivin e tij, Parathënien e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe Kuadrin për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare*. SNK 8 *Politikat kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabime* jep një bazë për përzgjedhjen dhe zbatimin e politikave kontabël në rastet e mungesës së udhëzimit të drejtpërdrejtë.

# Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 18

## Të ardhurat

### Objektivi

Në *Kuadrin për Përgatitjen dhe Paraqitjen e Pasqyrave Financiare* të ardhurat përcaktohen si rritje të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës kontabël në formën e hyrjeve ose shtimeve të aktiveve, ose pakësimeve të detyrimeve që sjellin rritje të kapitalit neto, të ndryshme nga ato të lidhura me kontributet nga pjesëmarrësit në kapitalin neto. Të ardhurat përfshijnë si të ardhurat ashtu edhe fitimet. Të ardhurat janë hyrje që vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike dhe të cilave u referohemi me lloje të ndryshme emrash që përfshijnë shitjet, tarifat, interesat, dividendët dhe të drejtat e përdorimit. Objektivi këtij Standardi është të përshkruajë trajtimin kontabël të të ardhurave që vijnë nga disa tipe të caktuara transaksionesh dhe ngjarjesh.

Çështja kryesore e kontabilitetit për të ardhurat është përcaktimi i momentit të njohjes së të ardhurave. Të ardhurat njihen kur përfitime të ardhshme ekonomike është e mundur që të hyjnë në njësinë ekonomike dhe këto përfitime të mund të maten në mënyrë të besueshme. Ky Standard përcakton rrethanat kur plotësohet ky kriter pra tregon dhe kur do të njihen të ardhurat. Standardi shërben gjithashtu si udhëzues për zbatimin e këtij kriteri.

### Objekti

- 1 **Ky Standard duhet të përdoret për kontabilizimin e të ardhurave që vijnë nga transaksionet dhe ngjarjet vijuese:**
  - (a) **shitja e mallrave dhe produkteve;**
  - (b) **kryerja e shërbimeve; dhe**
  - (c) **përdorimi nga të tretët i aktiveve të njësisë ekonomike që sjellin interes, të drejta përdorimi dhe dividendë.**
- 2 Ky Standard zëvendëson SNK 18 *Njohja e të Ardhurave* miratuar në 1982.
- 3 përfshijnë mallra dhe produkte të prodhuara nga njësia ekonomike me qëllim shitjen e tyre si dhe mallra dhe produkte të blera për rishitje, të tilla si mallrat e blera nga një shitës me pakicë ose tokë dhe pasuri të tjera të mbajtura për rishitje.
- 4 Zakonisht dhënia e shërbimeve përfshin kryerjen nga njësia ekonomike të një detyre të pranuar nëpërmjet një kontrate gjatë një periudhe kohore të pranuar. Ky shërbim mund të kryhet brenda një periudhe të vetme ose gjatë disa periudhave. Disa kontrata për kryerje shërbimesh janë të lidhura drejtpërsëdrejti me kontratat e ndërtimit, për shembull, ato për shërbimet e drejtuesve të projekteve dhe për arkitektët. Të ardhurat që vijnë nga këto kontrata nuk janë objekt i këtij Standardi, por trajtohen në përputhje me kërkesat për kontratat e ndërtimit, siç specifikohet në SNK 11 *Kontratat e Ndërtimit*.
- 5 Përdorimi nga të tretët i aktiveve të njësisë ekonomike krijon të ardhura në formën e:
  - (a) interesit—çmimi për përdorimin e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare ose shumave që i detyrohen njësisë ekonomike;
  - (b) të drejtat e përdorimit—çmimi i përdorimit i aktiveve afatgjata të njësisë ekonomike, për shembull patentat, markat tregtare, e drejta e autorit dhe softwarët e kompjuterave; dhe
  - (c) Dividendët—shpërndarja e fitimeve mes mbajtësve të investimeve në kapitalin neto në përputhje me kuotat përkatëse të kategorive të caktuara të kapitalit.
- 6 Ky Standard nuk trajton të ardhurat që vijnë nga:
  - (a) marrëveshjet e Qirave (shih SNK 17 *Qirate*);
  - (b) dividendët që vijnë nga investimet të cilat trajtohen sipas metodës së kapitalit neto (shih SNK 28 *Investime në Pjesëmarrje*);
  - (c) kontratat e sigurimit që janë objekt i SNRF 4 *Kontrata Sigurimi*;
  - (d) ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare ose detyrimeve financiare ose në vlerën e shitjes së tyre (shih SNK 39 *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja*); Njohje and Matje;
  - (e) ndryshimet në vlerën e aktiveve afatshkurtër;

- (f) njohja fillestare dhe ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve biologjike të lidhura me veprimtarinë bujqësore (shih SNK 41 *Bujqësia*);
- (g) njohja fillestare e prodhimit bujqësor (shih SNK 41); dhe
- (h) nxjerrja e mineraleve.

## Përkufizime

---

### 7 Më poshtë jepen përkufizimet e disa termave kryesore që përdoren në këtë standard:

***Të ardhurat janë hyrje bruto të përfitimeve ekonomike gjatë periudhës, të cilat vijnë nga veprimtaria e zakonshme e një njësie ekonomike kur këto hyrje sjellin rritje në kapitalin neto, përveç rritjeve që lidhen me kontributet nga pjesëmarrësit në kapital.***

***Vlera e drejtë është shuma me të cilën mund të shkëmbejë një aktiv, ose mund të shlyej një pasiv, midis palëve të vullnetëshme të mirëinformuara dhe të palidhura me njëra-tjetrën***

- 8 Të ardhurat përfshijnë vetëm hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike të marra dhe ato që janë për t'u marrë nga njësi ekonomike për llogari të vet. Shumat e mbledhura për llogari të palëve të treta si taksat e shitjes, taksat e mallrave, produkteve dhe shërbimeve, si dhe tatimi i vlerës së shtuar nuk janë përfitime ekonomike që hyjnë në njësinë ekonomike dhe nuk sjellin rritje të kapitalit neto. Për këtë arsye ato nuk përfshihen në të ardhurat. Në mënyrë të ngjashme, në rastin e një biznesi agjencie (një marrëdhënie ndërmjetësie), hyrjet bruto të përfitimeve ekonomike përfshijnë shuma të mbledhura për llogari të shoqërisë kryesore dhe nuk sjellin rritje në kapitalin neto të njësisë ekonomike. Shumat e mbledhura për llogari të shoqërisë kryesore nuk janë të ardhura tek agjensia. përkundrazi, e ardhur është vetëm komisioni.

## Matja e të Ardhurave

---

### 9 Të ardhurat duhet të maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose që është për t'u marrë.

- 10 Zakonisht shuma e të ardhurave që vijnë nga një transaksion përcaktohet nga marrëveshja mes njësisë ekonomike dhe blerësit ose përdoruesit të aktivit. Ajo matet me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose për t'u marrë duke marrë parasysh shumat e uljeve dhe zbritjeve tregtare të përfituara nga njësi ekonomike.

- 11 Në shumicën e rasteve shuma e konsideruar është në formën e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare dhe shuma e të ardhurave është shuma e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare të marra ose për t'u marrë. Megjithatë, kur hyrja e mjeteve monetare ose ekuivalentëve të mjeteve monetare shtyhet në kohë, vlera e drejtë e konsideratës mund të jetë më e vogël se shuma nominale e mjeteve monetare të marra ose për t'u marrë. Per shembull, një njësi ekonomike mund t'i ofrojë një kredi tregtare pa interes blerësit ose të pranojë nga blerësi një letër tregtare me interes më të ulët se tregu, si shumë e konsideruar për shitjen e mallrave dhe produkteve. Kur marrëveshja efektivisht perfaqëson me të vërtetë një transaksion financimi, vlera e drejtë e shumës së konsideratës përcaktohet nga skontimi i të gjithë shumave të ardhshme me një normë interesi të përcaktuar. Norma e interesit e përcaktuar është norma që përcaktohet në mes:

- (a) normës aktuale të një instrumenti të ngjashëm të një emetuesi me një klasifikim të ngjashëm kredie; ose
- (b) një norme interesi që skonton shumën nominale të instrumentit në vlerën aktuale të çmimit të shitjes në mjete monetare të mallrave dhe produkteve ose shërbimeve.

Diferenca mes vlerës së drejtë dhe vlerës nominale të shumës së konsideruar do të njihet si e ardhur nga interesi në përputhje me paragrafët 29 dhe 30 dhe në përputhje me SNK 39.

- 12 Kur mallrat dhe produktet ose shërbimet këmben ose jepen për mallra dhe produkte ose shërbime të ngjashme në natyrë dhe vlerë, këmbimi nuk konsiderohet si një transaksion i cili sjell të ardhura. Kjo ndodh shpesh me mallra dhe produkte si nafta ose qumështi, ku furnizuesit këmbajnë ose japin inventarë gjendje në zona të ndryshme me qëllim që të plotësojnë në kohë kërkesën në një zonë të caktuar. Kur shiten mallra ose kryhen shërbime në këmbim të mallrave dhe produkteve ose shërbimeve jo-të ngjashme, këmbimi konsiderohet si një transaksion i cili sjell të ardhura. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të mallrave dhe produkteve ose shërbimeve të marra, të korrigjuara për ndonjë shumë mjetesh monetare ose ekuivalente të tyre të transferuar. Kur vlera e drejtë e mallrave dhe produkteve ose shërbimeve të marra nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, të ardhurat do të maten me vlerën e drejtë të mallrave dhe produkteve ose shërbimeve të dhëna në këmbim të korrigjuara, me çdo shumë mjetesh monetare ose ekuivalente të tyre të transferuar.

## Identifikimi i transaksioneve

- 13 Në këtë Standard kriteret e njohjes zakonisht aplikohen veçmas për çdo transaksion. Megjithatë në disa raste është e nevojshme që kriteret e njohjes të aplikohen veçmas për çdo përbërës të identifikueshëm të një transaksioni në mënyrë që të reflektohet thelbi i transaksionit. Për shembull kur çmimi i shitjes së një produkti përfshin një shumë të identifikueshme për shërbimin pasues, kjo shumë duhet të zbritet dhe të njihet si e ardhur gjatë periudhës së kryerjes së shërbimit. Anasjelltas, kriteret e njohjes aplikohen njëkohësisht ndaj dy ose më shumë transaksioneve, kur këta janë të lidhur në mënyrë të tillë që efekti tregtar nuk mund të kuptohet pa iu referuar grupit të transaksioneve si një i vetëm. Për shembull, një njësi ekonomike mund të shesë mallra dhe produkte dhe në të njëjtën kohë të hyjë në një marrëveshje të veçantë për riblerjen e tyre në një date të mëvonshme, duke mohuar efektin e pavaruar të transaksionit; në një situatë të tillë, dy transaksionet do të trajtohen së bashku.

## Shitja e mallrave dhe produkteve

- 14 **Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve do të njihen kur të plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet vijuese:**
- (a) **njësia ekonomike ka transferuar tek blerësi risqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë e mallrave dhe produkteve;**
  - (b) **njësia ekonomike nuk është e përfshirë më në manaxhimin e mallrave dhe produkteve të shitura në nivelin që zakonisht sjell pronësinë dhe as nuk ka kontrollin efektiv të tyre**
  - (c) **shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme;**
  - (d) **është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike; dhe**
  - (e) **kostot që kanë ndodhur ose që do të ndodhin lidhur me transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme**
- 15 Vlerësimi nëse një njësi ekonomike ka transferuar risqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë tek blerësi, kërkon një analizë të rrethanave të transaksionit. Në shumicën e rasteve, transferimi i risqeve dhe përfitimeve lidhur me pronësinë përkon me transferimin e titullit ligjor ose kalimin në zotërim të blerësit. Kjo është situata që ndeshet më shpesh në shitjet me pakicë. Në rastet e tjera, transferimi i risqeve dhe përfitimeve lidhur me pronësinë ndodh në një moment të ndryshëm nga transferimi i titullit ligjor ose kalimi në zotërim.
- 16 Nëse një njësi ekonomike mban risqe të rëndësishme lidhur me pronësinë, transaksioni nuk konsiderohet si shitje dhe të ardhurat nuk njihen. Një njësi ekonomike mund të mbajë një risk të rëndësishëm lidhur me pronësinë në mënyra të ndryshme. Shembuj situatash në të cilat njësia ekonomike mban risqe dhe përfitime të rëndësishme lidhur me pronësinë jepen në vijim:
- (a) kur njësia ekonomike mban një detyrim për rezultate jo-të kënaqshme, që nuk mbulohet nga provizione normale garancie;
  - (b) kur marrja e të ardhurave nga një shitje e caktuar varet në një masë të caktuar nga të ardhurat e realizuara nga vetë blerësi i pronës kur ai shet mallrat dhe produktet;;
  - (c) kur mallrat dhe produktet janë dërguar dhe duhet të instalohen dhe instalimi zë një pjesë të rëndësishme të kontratës e cila nuk është përfunduar ende nga njësia ekonomike; dhe
  - (d) kur blerësi ka të drejtë të anulojë blerjen për një arsye të specifikuar në kontratën e shitjes dhe njësia ekonomike është e pasigurt për mundësinë e kthimit.
- 17 Nëse njësia ekonomike mban një risk jo-të rëndësishëm lidhur me pronësinë, transaksioni është një shitje dhe duhet të njihen të ardhurat. Për shembull, një shitës mund të mbajë titullin ligjor të mallrave dhe produkteve vetëm për të siguruar arkëtimin e shumave që i detyrohen. Në një rast të tillë, nëse njësia ekonomike ka transferuar risqet dhe përfitimet kryesore lidhur me pronësinë, transaksioni është shitje dhe të ardhurat duhet të njihen. Një tjetër shembull kur njësia ekonomike mban vetëm një risk të parëndësishëm lidhur me pronësinë, mund të jetë një shitje me pakicë që ofron kompensim për blerësin nëse ky i fundit është i pakënaqur. Në një rast të tillë të ardhurat do të njihen në momentin e shitjes në qoftë se shitësi mund të vlerësojë në mënyrë të besueshme kthimet e ardhshme dhe nje detyrim lidhur me kthimet mbeshtetur ne eksperiencen e meparshme dhe faktore te tjere te rendesishem.
- 18 Të ardhurat njihen vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike. Në disa raste kjo nuk mund të jetë e mundur derisa të merret shuma e konsideruar ose derisa të eliminohet pasiguria. Për shembull, mund të jetë e pasigurt që një autoritet qeveritar i huaj të jape lejen për faljen e shumave nga një shitje në një vend të huaj. Kur merret leja, pasiguria është eliminuar dhe të ardhurat

duhet të njihen. Megjithatë kur shfaqet një pasiguri lidhur me arkëtimin e një shume tashmë të përfshirë në të ardhurat, shuma e pambledhshme ose shuma për të cilën nuk është më e mundur mbledhja, do të njihet si një shpenzim dhe jo si një korigjim i shumës së të ardhurës të njohur më parë.

- 19 Të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura me të njëjtin transaksion ose ngjarje tjetër njihen njëkohësisht; zakonisht ky proces quhet përfaqja e të ardhurave me shpenzimet. Zakonisht shpenzimet, përfshirë garancitë dhe kostot e tjera që priten të ndodhin pas lëvrimit të mallrave dhe produkteve, mund të maten në mënyrë të besueshme kur plotësohen kushtet e tjera për njohjen e të ardhurave. Megjithatë, të ardhurat nuk mund të njihen nëse shpenzimet nuk mund të maten në mënyrë të besueshme; në rrethana të tilla, çdo shumë e konsideruar tashmë e marrë për shitjen e mallrave dhe produkteve do të njihet si detyrim.

## Sigurimi i shërbimeve

- 20 **Kur rezultati i një transaksioni që përfshin sigurimin e një shërbimi mund të matet në mënyrë të besueshme, të ardhurat e lidhura me transaksionin duhet të njihen në përputhje me fazën e realizimit të transaksionit në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare. Rezultati i një transaksioni mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme kur plotësohen njëkohësisht të gjithë kushtet e mëposhtëme:**
- (a) shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme
  - (b) është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin mund të hyjnë në njësinë ekonomike;
  - (c) faza e realizimit të transaksionit në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare mund të matet në mënyrë të besueshme; dhe
  - (d) |kostot e ndodhura për transaksionin dhe kostot për të perfunduar transaksionin mund të maten në mënyrë të besueshme.\*
- 21 Njohja e të ardhurave në përputhje me fazën e realizimit të një transaksioni shpesh quhet metoda e përqindjes së realizimit. Sipas kësaj metode të ardhurat do të njihen në ato periudha kontabile kur shërbimet janë kryer. Njohja e të ardhurave mbi këtë bazë siguron informacion të dobishëm lidhur me shtrirjen e aktivitetit të shërbimit dhe rezultatit gjatë periudhës. SNK 11 gjithashtu kërkon njohjen e të ardhurave mbi këtë bazë. |Zakonisht kriteret e këtij Standardi janë të aplikueshme për njohjen e të ardhurave dhe shpenzimeve të lidhura me to për një transaksion që përfshin sigurimin e shërbimeve.
- 22 Të ardhurat njihen vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike. Megjithatë, kur shfaqet pasiguri lidhur me mbledhshmërinë e një shume tashmë të përfshirë në të ardhurat, shuma e pambledhshme ose shuma për të cilën nuk është më e mundur mbledhja, do të njihet si një shpenzim dhe jo si një korigjim i shumës së të ardhurës së njohur më parë.
- 23 Zakonisht një njësi ekonomike mund të bëjë një vlerësim të besueshëm pasi të ketë rënë dakord me palët e tjera të transaksionit lidhur me sa vijon:
- (a) të drejtat detyruese të çdo pale lidhur me shërbimin për t'u siguruar dhe marrë nga palët;
  - (b) shumen e konsideruar për t'u këmbyer; dhe
  - (c) mënyrën dhe kushtet e marrëveshjes.
- Zakonisht është e nevojshme që njësi ekonomike të ketë një sistem efektiv të brendshëm të buxhetimit dhe raportimit financiar. Njësi ekonomike rishqyrton dhe, kur është e nevojshme, modifikon ose ndryshon vlerësimet lidhur me të ardhurat ndërsa realizon shërbimin. Nevoja për këto rishikime nuk do të thotë se rezultati i këtij transaksioni nuk mund të matet në mënyrë të besueshme.
- 24 Faza e realizimit të një transaksioni mund të përcaktohet sipas disa metodave. Një njësi ekonomike përdor atë metodë që mat në mënyrë të besueshme shërbimin e realizuar. Në varësi të natyrës së transaksionit, metodat mund të jenë si vijon:
- (a) mbikëqyrja e punës së kryer;
  - (b) shërbimi i kryer deri tani si përqindje ndaj gjithë shërbimit për t'u kryer; ose
  - (c) pjesa e kostove të ndodhura deri tani ndaj kostove totale të vlerësuara të transaksionit. Vetëm kostot që reflektojnë shërbimet e realizuara deri tani do të përfshihen në kostot e ndodhura. Vetëm kostot që

\* Shih gjithashtu KIS-27 Vlerësimi i Thelbit të Transaksioneve kundër Formës Ligjore të një Qiraje dhe KIS-31 Te Ardhurat— Transaksionet Barter që Përfshijnë Shërbime Publicitare

reflektojnë shërbimet e kryera ose për tu kryer do të përfshihen në kostot totale të vlerësuara të transaksionit.

Shpesh pagesat progresive dhe paradhëniet e marra nga klientët nuk reflektojnë shërbimet e kryera.

- 25 Për qëllime praktike, kur shërbimet realizohen përmes një numri të pacaktuar veprimesh gjatë një periudhe kohore të caktuar, të ardhurat do të njihen në mënyrë lineare përgjatë periudhës së caktuar me përjashtim të rastit kur ekziston mundësia e zbatimit të një metode tjetër që e përfaqson më mirë fazën e realizimit. Kur një veprim i caktuar është shumë më i rëndësishëm se veprimet e tjera, njohja e të ardhurave do të shtyhet deri në ndodhjen e veprimit të rëndësishëm.
- 26 **Nëse rezultati i një transaksioni që përfshin sigurimin e shërbimeve nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, të ardhurat do të njihen vetëm në masën e shpenzimeve të njohura si të rikuperueshme.**
- 27 Shpesh në fazat e para të një transaksioni mund të ndodhë që rezultati i transaksionit të mos matet në mënyrë të besueshme. Megjithatë, është e mundshme që njësia ekonomike të rikuperojë kostot e ndodhura të transaksionit. Prandaj të ardhurat do të njihen deri në nivelin e kostove të ndodhura që pritet të jenë të rikuperueshme. Duke qenë se nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme rezultati i transaksionit, nuk njihet fitimi.
- 28 Nëse rezultati i një transaksioni nuk mund të matet në mënyrë të besueshme dhe nuk ka mundësi që kostot e ndodhura të jenë të rikuperueshme, të ardhurat nuk do të njihen dhe kostot e ndodhura do të njihen si një shpenzim. Kur pasiguria, e cila pengoi vlerësimin e besueshëm të rezultatit të kontratës, nuk ekziston më, të ardhurat do të njihen në përputhje me paragrafin 20 dhe jo paragrafin 26.

## **Interesat, të drejtat nga dhënia ne përdorim dhe dividendët**

- 29 **Të ardhurat që vijnë nga përdorimi prej të tretëve i aktiveve të njësisë ekonomike duke sjellë interesa, të drejta nga dhënia në përdorim dhe dividendë duhet të njihen sipas përcaktimeve të dhëna në paragrafin 30 kur:**
- (a) është e mundur që përfitime ekonomike të lidhura me transaksionin të hyjnë në njësinë ekonomike; dhe
- (b) shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.
- 30 **Të ardhurat do të njihen duke u mbështetur si vijon:**
- (a) **interesi do të njihet duke përdorur metodën e interesit efektiv, siç përcaktohet në SNK 39, paragrafi 9 dhe AG5–AG8;**
- (b) **të drejtat nga dhënia në përdorim do të njihen sipas kontabilitetit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara në përputhje me thelbin e marrëveshjes së lidhur; dhe**
- (c) **dividendët do të njihen kur aksionerit i lind e drejta e marrjes së pagesës lidhur me dividendët.**
- 31 [Fshirë]
- 32 Nëse interesi i papaguar është konstatuar para blerjes së një investimi mbartës interesi, shuma e marrë më pas e interesit shpërndahet mes periudhave para dhe pas blerjes; vetëm pjesa që i takon periudhës pas blerjes do të njihet si e ardhur. Kur dividendët në letrat me vlerë të kapitalit janë deklaruar nga fitime para blerjes, këto dividendë do të zbriten nga kosto e letrave me vlerë. Nëse është e vështirë që të bëhet një shpërndarje, me përjashtim të një shpërndarjeje arbitrare, dividendët do të njihen si të ardhura me përjashtim të rastit kur ato përfaqësojnë qartësisht një rikuperim të kostos së letrave me vlerë të kapitalit.
- 33 Të drejtat nga dhënia në përdorim konstatohen në përputhje me kushtet e marrëveshjes së lidhur dhe zakonisht njihen sipas kësaj baze me përjashtim të rastit kur, duke iu referuar thelbit të marrëveshjes, është më e përshtatshme të njihen të ardhurat në një mënyrë tjetër sistematike dhe racionale.
- 34 Të ardhurat do të njihen vetëm kur është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike. Megjithatë, kur shfaqet një pasiguri lidhur me mbledhshmërinë e një shume tashmë të përfshirë në të ardhurat, shuma e pambledhshme ose shuma për të cilën nuk është më e mundur mbledhja, do të njihet si një shpenzim dhe jo si një korigjim i shumës së të ardhurës të njohur më pare.

## **Paraqitja**

- 35 **Një njësi ekonomike duhet të paraqesë:**
- (a) **politikat kontabile të përdorura për njohjen e të ardhurave, duke përfshirë në rastin e sigurimit të shërbimeve, metodat e përdorura për përcaktimin e fazes së realizimit të transaksionit;**



- (b) shumën e secilës kategori të rëndësishme të ardhurash të njohura gjatë periudhës, përfshirë të ardhurat nga:
- (i) shitja e mallrave dhe produkte;
  - (ii) Dhënie e shërbimeve;
  - (iii) Interes;
  - (iv) të drejtat nga dhënia në përdorim;
  - (v) Dividentët; dhe
- (c) shumën e të ardhurave të realizuara nga këmbimi i mallra dhe produktemallra dhe produkteve ose shërbimeve të përfshirë në secilën kategori të rëndësishme të ardhurash.

36 Një njësi ekonomike paraqet çdo detyrim dhe aktiv të mundshëm në përputhje me SNK 37 *Provizionet, Detyrimet dhe Aktivet e Mundshme*. Detyrimet dhe aktivet e mundshme mund të vijnë nga zëra si kosto të garancisë, pretendime, gjoha ose humbje të mundshme.

## **Data e hyrjes në fuqi**

---

37 Ky Standard është operativ për pasqyrat financiare që mbulojnë periudha që fillojnë e vijojnë përtej 1 Janar 1995.

## Shtojcë

*Kjo shtojcë shoqëron SNK 18 por nuk është pjesë e Standardit. Shembujt përqendrohen në aspekte të veçanta të një transaksioni dhe nuk përbejnë një trajtim të plotë të të gjithë faktorëve që mund të influencojnë njohjen e të ardhurave. Në përgjithësi, shembujt supozojnë se shuma e të ardhurës mund të matet në mënyrë të besueshme, se është e mundur që përfitime ekonomike të hyjnë në njësinë ekonomike dhe se kostot e ndodhura ose për të ndodhur mund të maten në mënyrë të besueshme.*

### Shitja e mallrave dhe produkteve

*Ligji në vende të ndryshme mund të paracaktoshë që kriteret e njohjes së këtij Standardi plotësohen në momente të ndryshme kohore. Në disa raste ligji mund të përcaktoshë momentin kohor të transferimit të risqeve dhe përfitimeve kryesore lidhur me pronësinë nga ana e njësisë ekonomike. Prandaj, shembujt në këtë seksion të shtojcës duhet të lexohen në kontekst me ligjet që u takojnë shitjes së mallrave dhe produkteve në vendin ku ndodh transaksioni.*

1 *Shitjet ‘faturato dhe mbaj’ , në të cilat lëvrimi i mallrave bëhet pas kërkesës së blerësit ndërkohë që blerësi merr titullin ligjor dhe pranon faturimin.*

E ardhura do të njihet kur blerësi merr titullin ligjor, nëse:

- (a) lëvrimi është i mundur që të bëhet;
- (b) në kohën e njohjes së shitjes, mallrat dhe produktet janë gjendje, janë të identifikuar dhe gati për t'u lëvruar tek blerësi;
- (c) blerësi pranon në mënyrë specifike instruksionet (opsionet) e lëvrimit të shtyrë; dhe
- (d) aplikohen kushtet e zakonshme të pagesës.

E ardhura nuk do të njihet nëse thjesht synohet të blihen ose prodhohen mallrat dhe produktet në kohën e lëvrimit të tyre.

2 *Lëvrimi i mallrave dhe produkteve i nënshtrohet disa kushteve*

(a) *instalimi dhe këqyrja.*

Zakonisht e ardhura do të njihet kur blerësi pranon dërgesën dhe janë realizuar instalimi e këqyrja. Megjithatë e ardhura do të njihet menjëherë pasi blerësi ka pranuar dërgesën nëse:

- (i) procesi i instalimit është i thjeshtë, për shembull instalimi i një antene marrëse televizive kërkon vetëm shpaketimin dhe lidhjen me burimin e energjisë dhe antenën ose
- (ii) këqyrja kryhet për qëllim të përcaktimit të çmimit final të kontratës, për shembull, transportet e mineralit të hekurit, sheqerit ose sojës.

(b) *miratimi nëse blerësi ka diskutuar për një të drejtë të kufizuar për kthime mbrapsht.*

Nëse ka pasiguri lidhur me mundësinë e kthimit mbrapsht, e ardhura do të njihet kur lëvrimi pranohet formalisht nga blerësi ose kur mallrat dhe produktet lëvrohen dhe afati i parashikuar për kthimet ka përfunduar.

(c) *shitjet me dergese mallrash tek marrësi sipas të cilave marrësi (blerësi) merr përsipër të shesë mallrat dhe produktet për llogari të dërguesit (shitësit).*

Të ardhurat do të njihen nga dërguesi kur mallra dhe produktet do të jenë shitur nga marrësi tek një palë e tretë

(d) *Arkëtim në momentin e lëvrimit të mallit tek blerësi.*

Të ardhurat do të njihen kur lëvrimi është bërë dhe mjetet monetare janë marrë nga shitësi ose agjenti i tij

3 *Shitjet me paradhënie sipas të cilave mallra dhe produktet do të lëvrohen kur blerësi bën pagesën e fundit të një serie pagesash me këste.*

Të ardhurat nga shitje të tilla do të njihen kur mallrat dhe produkte janë lëvruar. Megjithatë nëse eksperiencia tregon se pjesa më e madhe e shitjeve të tilla është plotësuar, të ardhurat mund të njihen kur është marrë një depozitë e rëndësishme dhe nëse mallrat dhe produktet janë gjendje, të identifikuar dhe gati për lëvrim tek blerësi.

- 4 Porosi kur pagesa (ose pagesa pjesore) është marrë paradhënie para lëvrimit të mallrave dhe produkte që nuk janë ende gjendje, për shembull mallrat dhe produktet janë ende për t'u prodhuar ose për t'u dërguar blerësit nga një palë e tretë.
- Të ardhurat do të njihen kur mallrat dhe produktet janë lëvruar tek blerësi.
- 5 Marrëveshjet e shitjes dhe riblerjes (përveç transaksioneve të shkëmbimit-swap) sipas të cilave shitësi njëkohësisht bie dakord të riblejë të njëjtat mallra dhe produktet një datë të mëvonshme ose kur shitësi ka një opsion blerje për riblerjen ose shitësi ka një kontratë me opsion që të kërkojë riblerjen nga shitësi i mallra dhe produkteve.
- Për marrëveshjet e shitjes dhe riblerjes së një aktivi të ndryshëm nga aktivet financiare, kushtet e marrëveshjes duhet të analizohen që të mund të sigurohemi se në thelb shitësi ka transferuar risqet dhe përfitimet lidhur me pronësinë tek blerësi dhe prej këtu do të njihen të ardhurat. Nëse shitësi mban ende risqe dhe përfitime lidhur me pronësinë, transaksioni është një marrëveshje financimi dhe nuk krijon të ardhura. Marrëveshjet e shitjes dhe riblerjes së një aktivi financiar trajtohen nga SNK 39 *Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja aplikohet*
- 6 *Shitja ndaj palëve ndërmjetëse, si shpërndarës, tregëtare ose palë të tjera për rishitje*
- Zakonisht të ardhurat nga shitje të tilla do të njihen kur janë transferuar risqet dhe përfitimet lidhur me pronësinë. Megjithatë, nëse blerësi në thelb është duke vepruar si një agjent shitjeje, shitja duhet të trajtohet si një shitje me dërgesë mallrash tek marrësi.
- 7 Abonimi në publikime dhe zërat e ngjashëm.
- Nëse zërat e përfshirë janë të një vlere të ngjashme në secilën periudhë, të ardhurat do të njihen në mënyrë lineare përgjatë periudhës në të cilën zërat janë dërguar. Nëse zërat ndryshojnë në vlerë nga periudha në periudhë, të ardhurat do të njihen në bazë të vlerës së shitjes së zërit të dërguar në përputhje me vlerën totale të vlerësuar të shitjeve të gjithë zërave të përfshirë në abonim.
- 8 *Shitjet me këste sipas të cilave shuma e konsideruar do të merret me këste*
- Të ardhurat që mund t'i ngarkohen çmimit të shitjes, me përjashtim të interesit, do të njihen në ditën e shitjes. Çmimi i shitjes është vera aktuale e shumës së konsideruar, të përcaktuar nga skontimi i kësteve për t'u marrë me një normë të caktuar interesi. Elementi interes do të njihet si e ardhur kur realizohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv.
- 9 *Shitjet e pasurive të patundshme.*
- Zakonisht e ardhura do të njihet kur titulli ligjor i kalon blerësit. Megjithatë sipas disa juridiksioneve interesi i çmuar drejt i një pasurie mund t'i kalojë blerësit më parë se transferimi i titullit ligjor, prandaj risqet dhe përfitimet lidhur me pronësinë transferohen në këtë fazë. Në të tilla raste, nëse shitësit nuk i mbeten për të kryer veprime të rëndësishme për plotësimin e kontratës, mund të jetë e përshtatshme të njihet e ardhura. Në raste e tjera, nëse shitësi është i detyruar të kryejë veprime të rëndësishme pas transferimit të titullit të drejtë dhe/ose ligjor, të ardhurat do të njihen pasi të përfundojnë veprimet. Një shembull i kësaj mund të jetë një ndërtesë ose një ambjent tjetër, ndërtimi i së cilës nuk ka përfunduar ende.
- Në disa raste pasuria e patundshme mund të shitet me një nivel të vijimit të përfshirjes së shitësit që nuk bën të mundur transferimin e risqeve dhe përfitimeve të pronësisë. Shembuj janë marrëveshjet e shitjes dhe riblerjes të cilat përfshijnë opsione të shitesit dhe blerësit dhe marrëveshjet sipas të cilave shitësi garanton zënien e pronës për një periudhë të caktuar ose garanton një kthim në investimin e blerësit për një periudhë të caktuar. Në të tilla raste trajtimi i transaksionit do të përcaktohet nga natyra dhe niveli i përfshirjes së vijueshme të shitësit. Ai mund të trajtohet si shitje, ose si financim, si qiradhënie ose si ndonjë marrëveshje tjetër fitimshjellëse. Nëse transaksioni trajtohet si shitje, vazhdimi i përfshirjes së shitësit mund të vonojë njohjen e të ardhurave.
- Gjithashtu një shitës duhet të marrë në konsideratë mjetet e pagesës dhe provat lidhur me premtimin e blerësit për të përfunduar pagesat. Për shembull, nëse shuma totale e pagesave të marra, përfshirë pagesën fillestare të blerësit, ose pagesat në vijm të blerësit, përbëjnë një provë të pamjaftueshme lidhur me premtimin e blerësit për të përfunduar pagesat, të ardhurat do të njihen vetëm në masën e mjeteve monetare të arkëtuara.

## Sigurimi i shërbimeve

---

- 10 *Komisionet e Instalimit.*
- Komisionet e instalimit do të njihen si të ardhura duke iu referuar fazës së plotësimit të instalimit, me përjashtim të rastit kur ato janë rastësore lidhur me shitjen e produktit. Në këtë rast ato do të njihen kur mallra dhe produktet shiten.
- 11 *Komisionet e shërbimit të përfshira në çmimin e produktit*

Nëse çmimi i shitjes së një produkti përfshin një shumë të identifikueshme për shërbimet në vijim (për shembull mbështetjen pas-shitjes dhe përmirësimin e produktit në rastin e shitjes së software-ve), kjo shumë do të shtyhet dhe njihet si e ardhur gjatë periudhës së kryerjes së shërbimit. Shuma e shtyrë pritet të mbulojë kostot e pritshme të shërbimeve, shërbime këto të cituara në marrëveshje, së bashku me pjesën e fitimit të arsyeshëm për këto shërbime.

12 *Komisionet publicitare.*

Komisionet e medias do të njihen kur publiciteti apo reklama lidhur me to do të shfaqet në publik. Komisionet e prodhimit do të njihen në përputhje me fazën e përfundimit të projektit.

13 *Komisionet e agjencive të sigurimit.*

Komisionet e agjencive të sigurimit të marra ose për t'u marrë, të cilat nuk kërkojnë kryerjen e një shërbimi të mëtejshëm nga ana e agentit, do të njihen si të ardhura për agentin në datën efektive të fillimit ose rinovimit të policës së lidhur me të. Megjithatë nëse vlerësohet se agentit do t'i duhet të kryejë një shërbim të mëtejshëm gjatë jetës së policës, do të shtyhet njohja si e ardhur e komisionit ose e një pjese të tij përgjatë periudhës gjatë së cilës policia është në fuqi.

14 *Komisionet e shërbimeve financiare.*

Njohja e të ardhurave për shërbimet financiare varet nga qëllimet për të cilat janë caktuar komisionet dhe baza e kontabilitetit për ndonjë instrument financiar të lidhur me të. Përshkrimi si komisione për shërbime financiare mund të mos jetë tregues për natyrën dhe thelbin e shërbimeve të dhëna. Prandaj është e rëndësishme të bëhet dallimi mes komisioneve që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv të një instrumenti financiar komisioneve që fitohen me sigurimin e shërbimeve dhe komisioneve që fitohen me realizimin e një veprimi të rëndësishëm.

(a) *Komisionet që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv të një instrumenti financiar.*

Zakonisht komisione të tilla trajtohen si një korigjim i normës së interesit efektiv. Megjithatë nëse instrumenti financiar matet me vlerën e drejtë, ku ndryshimet nga vlera e drejtë njihen si fitime ose humbje, komisionet do të njihen si të ardhura në momentin e njohjes së instrumentit.

(i) *Komisionet fillestare të marra nga një njësi ekonomike lidhur me krijimin ose blerjen e një aktivi financiar të ndryshëm nga ata të trajtuar në SNK 39 si të aktive financiare 'me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes'*

Komisione të tilla mund të përfshijnë kompensimin për aktivitete të tilla si vlerësimi i gjendjes financiare të huamarrësit, vlerësimi dhe regjistrimi i garancive, pengjeve dhe marrëveshjeve të tjera të sigurimit, diskutimi i kushteve të një instrumenti, përgatitja dhe përpunimi i dokumentave dhe mbyllja e transaksionit. Këto komisione janë pjesë përbërëse të sjellin si rezultat një instrument financiar dhe, së bashku me kostot direkte të lidhura me to, shtyhen në kohë dhe njihen si një korigjim i normës efektive të interesit.

(ii) *ionet e angazhimit të marra nga njësi ekonomike për dhëniene një huaje, kur angazhimi (premtimi për huanë) nuk është objekt i SNK 39.*

Nëse është e mundur që njësi ekonomike do të hyjë në një marrëveshje të caktuar huadhënie dhe angazhimi për huanë nuk është objekt i SNK 39, komisioni i angazhimit i marrë do të shihet si një kompensim për një përfshirje në progres me blerjen e një instrumenti financiar dhe së bashku me kostot direkte të lidhura me to shtyhen në kohë dhe njihen si një korigjim i normës efektive të interesit. Nëse angazhimi përfundon pa dhëniene e huasë nga njësi ekonomike, komisioni do të njihet si e ardhur në mbarim të afatit. Angazhimet për huadhënie, objekt i SNK 39 trajtohen si derivativë dhe maten me vlerën e drejtë.

(iii) *Komisionet fillestare të marra në emetimin e detyrimeve financiare të matura me koston e amortizuar.*

Këto komisione janë pjesë përbërëse dhe sjellin si rezultat një detyrim financiar. Nëse detyrimi financiar nuk klasifikohet si 'me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes', komisionet fillestare të marra përfshihen, së bashku me kostot e ndodhura të transaksionit, në vlerën fillestare që mbart detyrimi financiar dhe njihen si një korigjim i normës së interesit efektiv. Një njësi ekonomike duhet të dallojë komisionet dhe kostot që janë pjesë përbërëse e normës së interesit efektiv për detyrimet financiare, nga komisionet fillestare dhe kostot e transaksionit të lidhura me të drejtën për të dhënë shërbime, si për shembull shërbimet e manaxhimit të investimeve.

(b) *Komisionet e fituara gjatë kryerjes së shërbimeve.*

(i) *Komisionet e ngarkuara për shërbimin e një huaje*

Komisionet e ngarkuara nga një njësi ekonomike për shërbimin e një huaje do të njihen si të ardhura kur shërbimet janë kryer.

- (ii) *Komisionet e angazhimit për dhënien (nxjerrjen) e një huaje, kur marrëveshja e huasë nuk është objekt i SNK 39*

Nëse nuk është e mundur që marrëveshja e huadhënies të trajtohet sipas SNK 39 dhe angazhimi i huasë nuk është objekt i SNK 39, komisionet e angazhimit do të njihen si të ardhura të shpërndara në kohë në përputhje me periudhën e angazhimit. Angazhimet për huanë që janë objekt i SNK 39 do të trajtohen si derivativë dhe maten me vlerën e drejtë.

- (iii) *Komisionet e manaxhimit të investimeve*

Komisionet e ngarkuara për drejtimin e investimeve do të njihen si të ardhura kur shërbimet janë kryer

Kostot shtesë që lidhen drejtpërsëdrejti me sigurimin e një kontrate të drejtimit të investimeve do të njihen si një aktiv nëse mund të identifikohen veçmas e maten në mënyrë të besueshme dhe nëse është e mundur që ato të rikuperohen. Ashtu si në SNK 39, kosto shtesë është ajo kosto e cila nuk do të kishte ndodhur nëse njësi ekonomike nuk do të siguronte kontratën e drejtimit të investimeve. Aktivitë përfaqëson të drejtën kontraktuale të njësisë ekonomike të përfitojë nga kryerja e shërbimeve të manaxhimit të investimeve dhe do të amortizohet me njohjen e të ardhurave të lidhura me të nga njësi ekonomike. Nëse njësi ekonomike ka një portofol të kontratave të manaxhimit të investimeve mund të vlerësojë rikuperimin e tyre mbi bazë portofoli.

Disa kontrata shërbimesh financiare përfshijnë si një apo disa nga instrumentat financiarë fillestarë ashtu dhe provizionin për shërbimet e drejtimit të investimeve. Një shembull është një kontratë afatgjatë kursimesh mujore e lidhur me drejtimin e një grupi letrash me vlerë të kapitalit. Ofruesi i kontratës duhet të dallojë kostot e transaksionit të lidhura me instrumentin financiar fillestar nga kostot e sigurimit të së drejtës të dhënies së shërbimeve të manaxhimit të investimeve.

- (c) *Komisionet që fitohen nga përfundimi i një veprimi të rëndësishëm.*

Komisionet do të njihen si të ardhura nëse përfundohet një veprim i rëndësishëm si në shembujt më poshtë.

- (i) *Komisionet në ndarjen e aksioneve të një klienti.*

Komisioni do të njihet si e ardhur kur aksionet të jenë ndarë.

- (ii) *Komisionet e Vendorsjes për rënie dakort për një hua mes një huamarrësi dhe një investori.*

Komisioni do të njihet si e ardhur kur marrëveshja e huasë të jetë lidhur.

- (iii) *Komisionet për huatë sindikatë.*

Një komision sindikatë i marrë nga një njësi ekonomike që realizon një hua dhe nuk mban pjesë të paketës së huasë për vete (ose mban një pjesë me një normë interesi efektiv të njëjtë për risk të krahasueshëm si për pjesëmarrësit e tjerë) është kompensim për shërbimin sindikatë. Një komision i tillë do të njihet si e ardhur kur veprimi si sindikatë të ketë përfunduar.

15 *Komisionet e pranimit*

Të ardhurat nga aktiviteti artistik, banketet dhe ngjarje të tjera speciale do të njihen kur ndodh ngjarja. Nëse është shitur një abonim për një numër ngjarjesh, komisioni do të shpërndahet për çdo ngjarje mbi një bazë e cila paraqet nivelin e realizimit të shërbimeve në secilën ngjarje.

16 *Komisionet e studimit.*

Të ardhurat do të njihen përgjatë periudhës së marrjes së mësimave.

17 *Komisionet e fillimit, hyrjes dhe anëtarësimit.*

Njohja e të ardhurave varet nga natura e shërbimeve të dhëna. Nëse komisioni lejon vetëm anëtarësimin dhe gjithë shërbimet ose produktet e tjera janë paguar veçmas, ose nëse ekziston një abonim vjetor i veçantë, komisioni do të njihet si e ardhur nëse nuk ekziston ndonjë pasiguri e rëndësishme lidhur me mbledhshmërinë e tij. Nëse komisioni i jep të drejtë anëtarit për shërbime ose publikime për t'u dhënë gjatë periudhës së anëtarësimit, ose për të blerë mallra dhe produkte apo shërbime me çmime më të ulëta se ato që u ofrohen jo-anëtarëve, ai do të njihet në një bazë e cila reflekton kohën, naturën dhe vlerën përfitimeve të siguruara.

18 *Komisionet e franshizës*

Komisionet e franshizës mund të mbulojnë ofertën fillestare dhe në vijim të shërbimeve, pajisjeve dhe aktiveve të tjera të prekshme dhe të njohurive. Prandaj komisionet e franshizës do të njihen si të ardhura mbi një bazë e cila do të reflektojë qëllimin për të cilin komisionet ishin caktuar (ngrkuar). Janë të përshtashme metodat e mëposhtme të njohjes së komisioneve të franshizës:

(a) *Furnizuesit e pajisjeve dhe aktiveve të tjera të prekshme.*

Mbështetur në vlerën e drejtë të aktiveve të shitura, shuma do të njihet si e ardhur kur të jenë lëvruar zërat ose të jenë transferuar titujt.

(b) *Furnizuesit e shërbimeve fillestare dhe në vijim.*

Komisionet për furnizimin me shërbime të vazhdueshme, pjesë të një komisioni fillestar ose të një komisioni të veçantë, do të njihen si të ardhura gjatë sigurimit të shërbimeve. Nëse komisioni i veçantë nuk mbulon koston e shërbimeve të vazhdueshme së bashku me një fitim të arsyeshëm, pjesë të komisionit fillestar, të mjaftueshëm për të mbuluar kostot e shërbimeve të mjaftueshme dhe për të siguruar një fitim të arsyeshëm në këto shërbime, do të shtyhet në kohe dhe do të njihet si e ardhur kur kryhen shërbimet.

Marrëveshja e franshizës mund t'i kërkojë franshizor-it të ofrojë pajisje, inventarë ose aktive të tjera të prekshme me një çmim më të ulët sesa për të tjerët ose me një çmim që nuk i siguron një fitim të arsyeshëm në këto shitje. Në këto rrethana, pjesa e komisionit fillestar, e mjaftueshme për të mbuluar kostot e vlerësuar që tejkalojnë këtë çmim dhe për të siguruar një fitim të arsyeshëm mbi këto shitje do të shtyhet dhe do të njihet përgjatë periudhës që mallra dhe produktet pritet t'i shiten franshizës. Pjesa e mbetur e komisionit fillestar do të njihet si e ardhur kur të ketë përfunduar pjesa më e rëndësishme e shërbimeve fillestare dhe detyrimet e tjera të kërkuara nga franshizori (si asistenca në zgjedhjen e vendit, trainimi i personelit, financimi dhe publiciteti).

Shërbimet fillestare dhe detyrime të tjera të përfshira në një marrëveshje franshize varen nga numri i tregjeve individuale të vendosura në atë zonë. Në këtë rast komisioni që i takon shërbimeve fillestare do të njihet si e ardhur në përpjestim me numrin e tregjeve për të cilat janë përfunduar (në pjesën më të rëndësishme) shërbimet fillestare.

Nëse komisioni fillestar është i mbledhshëm për gjatë një periudhe kohore dhe ka një pasiguri të rëndësishme që ai të mund të arkëtohet plotësisht, komisioni do të njihet me marrjen e kësteve në mjete monetare.

(c) *Komisionet e franshizës së vazhdueshme.*

Komisionet e përcaktuara për përdorimin e vazhdueshëm të së drejtës së dhënë nga marrëveshja ose për shërbime të tjera për t'u dhënë gjatë periudhës së marrëveshjes, do të njihen si të ardhura kur janë kryer shërbimet ose përdorur të drejtat.

(d) *Transaksionet e agjencisë.*

Transaksionet mund të ndodhin mes franshizorit dhe franshizës të cilat në thelb përfshijnë franshizorin që vepron si agjent për franshizën. Për shembull franshizori mund të bëjë porosi dhe të kujdeset për lëvrimin e tyre për llogari të franshizes pa fitim. Transaksione të tilla nuk sjellin të ardhura.

19 *Komisione nga ndërtimi zhvillimi i software-ve të personalizuar.*

Komisionet nga ndërtimi i software-ve të personalizuar do të njihen si të ardhura duke iu referuar fazës së përfundimit të ndërtimit, përfshirë përfundimin e shërbimeve të bëra për mbështetjen pas shërbimit të lëvrimit

## **Interesat, të drejtat nga dhënia në përdorim dhe dividendët**

---

20 *Komisionet për licensën dhe të drejtën nga dhënia në përdorim.*

Zakonisht komisione dhe privilegje të paguara për përdorimin e aktiveve të njësisë ekonomike (si markat tregtare, patentat, software, e drejta e autorit për muzikën, regjistrimin dhe transmetimin e filmave) do të njihen në përputhje me thelbin e marrëveshjes. Për arsye praktike kjo mund të jetë një shpërndarje lineare përgjatë jetës së marrëveshjes, për shembull rasti i një license për përdorimin e një teknologjie të caktuar për një periudhë kohore të përcaktuar.

Caktimi i të drejtave kundrejt një komisioni fiks ose një garancie të pakthyeshme sipas një kontrate të pazgjydhshme që i lejon të licënsuarit të përdorë lirisht këto të drejta dhe dhënësi i licënsës nuk ka detyrime të mbetura për të realizuar, është në thelb një shitje. Një shembull është marrëveshja për përdorimin e një software ku dhënësi i licënsës nuk ka detyrime lidhur me lëvrimin e mëtejshëm. Një tjetër shembull është garantimi i të drejtës për shfaqjen e një filmi në tregjet ku dhënësi i licënsës nuk ka kontroll mbi shpërndarjen dhe nuk pret të marrë të ardhura të tjera nga shfaqja e filmit në këto vende. } Në raste të tilla të ardhurat do të njihen në momentin e shitjes.

Në disa raste nëse një komision licënsë ose e drejte përdorimi do të merret ose jo është i lidhur me ndodhjen e një ngjarjeje në të ardhmen. Në të tilla raste të ardhurat do të njihen vetëm nëse është e mundur që komisioni do të merret, që zakonisht është rasti kur ngjarja ka ndodhur.

